



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



01 Nr. 09 /25
Me 30.05.2025
Mamushë

Duke u bazuar në nenin 12 pika 12.2 shkronja d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronjën c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit Nr. 03L/048 për Menaxhmin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, nenit 6 dhe paragrafit 7 të nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 44.1 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008, Kuvendi i Komunës së Mamushës në seancën e rregullt të mbajtur me datë 30.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024, dhe bartja e mjeteve të pa shpenzuara të të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025

Neni 1

Aprovohet e kërkesa e Kryetarit të Komunës mbi miratimin e rritjes së buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024, dhe bartja e mjeteve të pa shpenzuara të të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025 në shumën prej 30,184.12€. Tejkalimi i të hyrave vetanake në vitin 2024 është në shumën prej 9,851.49€, mos realizimi i shpenzimit nga të hyrat e bartura në vitin 2024 fondi (22) është në shumën prej 16,700.00€ dhe mos realizimi i të hyrave vetanake në vitin 2024 fondi (21) është në shumën prej 3,632.63€.

Neni 2

Bartja të hyrave vetanake në shumën 30,184.12€. të buxhetohet si në vijim:

- 2.1 Në kategorin e shpenzimeve kapitale, nën-programi Administrata(16314), sipas përshkrimit të projektit " Gjenerator dhe paisje elektrike për pastrimin e dyshemeve-për objektet komunale (administrat, arsim dhe shëndetësi) dhe bllok kodues 22/626/16314/30/I RI/0133 në shumën prej 22,000.00€.
- 2.2 Në kategorin mallra dhe shërbime, nën-programi Administrata(16314), sipas bllokut kodues 22/626/16314/13/00000/0133, në shumën prej 4,000.00€.
- 2.3 Në kategorin shpenzime komunale, nën-programi Administrata(16314), sipas bllokut kodues 22/626/16314/14/00000/0133, në shumën prej 4,184.12€.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit dhe për zbatimin e këtij vendimi autorizohet Zyra e Kryetarit përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa/ZKF.

Arsyetim:

Kategoria-Shpenzime kapitale në shumën prej 22,000.00€, bartja e mjeteve në këtë kategori është për arsye se, janë destinuar tek nën-programi 16314-Administrata, Drejtoria e Administratës është caktuar si bartëse e këtij projekti për të gjitha njësit e Komunës së Mamushës për projektin e Përformancës Komunale për vitin 2023. Ne si Institucion jemi përfitues të Grantit të Përformancës për vitin 2023 periudha e alokimit bëhet në vitin fiskal 2025 të aprovuar nga Komisioni i Përformancës Komunale me datë 10.02.2025 i financiar nga donatori Helvetas i përfaqësuar nga menaxheri i projektit Demos. Vlera e financimit nga Demos është në shumën prej 52,333.66€ dhe vlera e bashkëfinancimit nga komuna është në shumën prej 22,000.00€. Komuna e Mamushës, ka për prioritet të ofrojë kushte më të mira pune dhe higjienë në objektet komunale, duke siguruar ambiente të pastra dhe të shëndetshme për administratën publike, institucionet arsimore dhe ato shëndetësore. Duke marrë parasysh rëndësinë e ruajtjes së higjienës në hapësira me frekuencim të lartë, nevojitet zbatimi i teknologjive të reja dhe inovative që mundësojnë pastrim më efikas dhe ekonomik. Projekti "Gjenerator dhe paisje elektrike për pastrimin e dyshemeve" synon të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të mirëmbajtjes në objektet komunale, duke kontribuar në: përmirësimin e kushteve të higjienës, zvogëlimin e kostove operacionale, rritjen e efikasitetit të pastrimit, zvogëlimin e ndotjes mjedisore dhe konsumit të energjisë.

Ky projekt përputhet plotësisht me strategjinë e organizatës për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, shfrytëzimin racional të burimeve financiare dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetarët. Në këtë kontekst, zbatimi i këtij projekti është thelbësor për të përmbushur prioritetet dhe objektivat strategjike të organizatës.

Kategoria Mallra dhe Shërbime në shumën prej 4,000.00€, bartja e mjeteve në këtë kategori është për arsye se, ne si OB kemi nevojë që për nevojat e administratës, shëndetësisë dhe arsimit, mjetet janë destinuar të barten tek një nën-program pra 16314-Administrata pasi që shuma është e ulët dhe sipas legjislacionit ka të drejtë të i ndihmohet arsimit dhe shëndetësisë dhe njësit tjerë kërkuar për ti mbuluar nevojat për shërbime, furnizime dhe blerje tjera gjatë vitit 2025 sipas kontratave që kemi në dispozicion.

Kategoria Shpenzime Komuna në shumën prej 4,184.12€, bartja e mjeteve në këtë kategori është për arsye se, shpenzimet e kësaj kategorie janë më të larta se sa viti i kaluar dhe kemi nevojë që obligimet të paguhen si shak e ngritjes së çmimeve.

Mjetet e mbetura nga fondi 21 janë të përfunduara të gjitha pagesat konform kontratave përkatëse dhe mjetet e mbetura nga fondi 22 janë mjete për të cilat OB i ka përfunduar sipas plotikave dhe strategjive komunale. Destinimi i mjeteve në arsim dhe shëndetësi nuk cenohet për arsye se janë të përfunduara dhe tejkaluara financiarisht në sektorin e shëndetësisë në vitin 2024, ku OB ka pranuar donacion nga Ambasada Japoneze në shumën prej 69,000.00€ dhe në arsim nuk ka patur mjete të planifikuara nga të hyrat vetanake. Bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake mbetet në përgjegjësinë e organizatës buxhetore Komuna e Mamushës për mbulesë buxhetore dhe realizim,

Me këtë vendim njoftohën:

1. Zyra e Kryetarit të Komunës
2. MAPL
3. Departamenti i Buxhetit Komunal – MFPT
4. Arkiv

Kryesues i Kuvendit të Komunës

Necmedin Morina





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



KUVENDI I KOMUNËS SË MAMUSHËS

01. Nr. 08 -25

Me 30.05.2025

Mamushë

Në bazë të nenit 12.2 pika (d) nenit 40 pika (j) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 7 dhe 18 të Ligjit për Bashkëpunim ndërkomunal nr.04/L-010, si dhe sipas nenit 40 të Statutit të Komunës së Mamushës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28.08.2025 miratoi:

V E N D I M

I

Miratohet NISMA e Kryetarit të Komunës së Mamushës për të hyrë në Binjakëzim Komunal Ndërkombëtar ndërmjetë Komunës së Mamushës dhe Komunës Yozgat të Republikës së Turqisë.

II

Autorizohet Kryetari i Komunës së Mamushës z. Abdülhadi Krasniç që ti filloj konsultimet dhe përgaditjen e propozim Marrëveshjes për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar.

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.

IV

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit, si dhe ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së, konform nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, dhe Rregullores së MAPL-së Nr.02/2021, për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpallje publike në web-faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim të njoftohen:

1. Zyra e Kryetarit të Komunës
2. Ministria e Pushtetit Lokal
3. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit

Nesmedin Morina

